REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Nr. 1725/2 Prot.

Tiranë, më 09.11.2026

UDHËZIM[1]

Nr. 3, datë 09.11.2026

PËR
ZBATIMIN E RREGULLORES 1889/2002 NË LIDHJE ME SHPËRNDARJEN E SHËRBIMEVE TË NDËRMJETËSIMIT FINANCIAR TË MATUR NË MËNYRË INDIREKTE (FISIM) BRENDA SISTEMIT EVROPIAN TË LLOGARIVE KOMBËTARE DHE RAJONALE (ESA 2010)

Bazuar në nenin 17, pika 4, dhe nenin 20, shkronja "b", të ligjit Nr. 17/2018 "Për statistikat zyrtare", ligjin Nr. 30/2022 "Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022–2026", në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026, miratuar me vendimin Nr. 16, datë 11.01.2024, si dhe në vendimin Nr. 25, datë 27.10.2026, të Bordit Drejtues të Institutit të Statistikave,

U DH Ë Z O J:

1. Zbatimin e Rregullores (KE) Nr. 1889/2002, në lidhje me shpërndarjen e shërbimeve të ndërmjetësimit financiar të matura në mënyrë indirekte (FISIM) brenda Sistemit Evropian të Llogarive Kombëtare dhe Rajonale (ESA 2010), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Prodhimit Statistikor dhe strukturat e tjera përkatëse në varësi të saj për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Lantona Sado

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - INSTITUTI I STATISTIKAVE - TIRANË

[1] Ky udhëzim përafron plotësisht Rregulloren e Komisionit (KE) Nr. 1889/2002 e 23 tetorit 2002, CELEX 32002R1889

RREGULLORJA E KOMISIONIT (KE) Nr. 1889/2002
e 23 tetorit 2002
mbi zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 448/98 që plotëson dhe ndryshon Rregulloren (KE) Nr. 2223/96 në lidhje me shpërndarjen e shërbimeve të ndërmjetësimit financiar të matura në mënyrë të tërthortë (FISIM) brenda Sistemit Evropian të Llogarive kombëtare dhe rajonale (ESA)

(Tekst me rëndësi për Zonën Ekonomike Evropiane ZEE-në)

KOMISIONI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për themelimin e Bashkimit Evropian,

Duke pasur parasysh Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 448/98 të 16 shkurtit 1998 që plotëson dhe ndryshon Rregulloren (KE) Nr. 2223/96 në lidhje me shpërndarjen e shërbimeve të ndërmjetësimit financiar të matura në mënyrë të tërthortë (FISIM) brenda Sistemit Evropian të Llogarive kombëtare dhe rajonale ESA (1), dhe në veçanti Nenin 5(3) të saj,
Duke qenë se:

(1) Rregullorja e Këshillit (KE) Nr. 2223/96 e 25 qershorit 1996 mbi Sistemin Evropian të llogarive kombëtare dhe rajonale të BE-së (2), e ndryshuar së fundmi nga Rregullorja (KE) Nr. 359/2002 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (3), (këtej e tutje "ESA 95") përmban kuadrin e referencës së standardeve të përbashkëta, përkufizimeve, klasifikimeve dhe rregullave kontabël për hartimin e llogarive të Shteteve Anëtare për nevojat statistikore të BE-së, me qëllim që të arrihen rezultate të krahasueshme midis Shteteve Anëtare.

(2) Rregullorja (KE) Nr. 448/98, në Shtojcën I të saj, ndryshoi Shtojcën A të Rregullores (KE) Nr. 2223/96 me qëllim që të prezantonte në metodologjinë e ESA 95 parimin për shpërndarjen e FISIM-it dhe të përcaktonte metoda eksperimentale të shpërndarjes së FISIM-it, të cilat duhej të testoheshin nga Shtetet Anëtare nga viti 1995 deri në vitin 2001, duke qenë se periudha e provës ishte mjaftueshëm e gjatë për të vlerësuar nëse shpërndarja jepte rezultate më të besueshme sesa alokimi aktual zero për matjen e saktë të aktivitetit ekonomik në fjalë.

(3) Në përputhje me Nenin 5(1) të Rregullores (KE) Nr. 448/98, një raport përfundimtar i është paraqitur më 21 qershor 2002 Parlamentit Evropian dhe Këshillit nga Komisioni, i cili përmban një analizë cilësore dhe sasiore të implikimeve të metodave eksperimentale për shpërndarjen dhe llogaritjen e FISIM-it. Ky raport përfundimtar doli në përfundimin se rezultatet e periudhës së provës ishin pozitive, pasi njihet gjerësisht se shpërndarja e FISIM-it do të çonte në

përmirësime të mëdha në metodologjinë e ESA 95 dhe në një krahasim më të saktë të niveleve të produktit të brendshëm bruto (PBB) brenda Bashkimit Evropian.

(4) Duke qenë se gjetjet e raportit përfundimtar të vlerësimit mbi besueshmërinë e rezultateve të marra gjatë periudhës së provës kanë qenë pozitive, metoda që do të përdoret për shpërndarjen e FISIM-it duhet të miratohet përpara datës 31 dhjetor 2002 në përputhje me Nenin 5(3) të Rregullores (KE) Nr. 448/98.

(5) Në raportin e tij përfundimtar paraqitur Parlamentit Evropian dhe Këshillit, Komisioni konsideroi se dy vite shtesë mund të ishin të dobishme për t'u mundësuar Shteteve Anëtare të bëjnë përmirësime të mëtejshme në burimet dhe metodat e përdorura për shpërndarjen e FISIM-it.

(6) Komiteti për Statistikat Monetare, Financiare dhe të Bilancit të Pagesave (CMFB), i ngritur me Vendimin e Këshillit 91/115/KEE (4), i ndryshuar me Vendimin 96/174/KE (5), është konsultuar.

(7) Masat e parashikuara në këtë Rregullore janë në përputhje me mendimin e Komitetit të Programit Statistikor (SPC).

KA MIRATUAR KËTË RREGULLORE:

Neni 1

1. Shtetet Anëtare kryejnë llogaritjet dhe shpërndarjet e mëposhtme në përputhje me metodologjinë e detajuar të përshkruar në Shtojcën III të Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 448/98:
(a) llogaritjen dhe shpërndarjen e FISIM-it midis sektorëve përdorues, duke përdorur normën e referencës të përcaktuar si "metoda 1" në pikën 1(b) të Shtojcës III të Rregullores së Këshillit (KE) nr. 448/98;[2]

(b) llogaritjen dhe shpërndarjen e FISIM-it të importuar dhe të eksportuar (përfshirë FISIM-in midis ndërmjetësve financiarë rezidentë dhe ndërmjetësve financiarë jorezidentë), duke përdorur normën e referencës të përcaktuar si norma e referencës "e jashtme" në pikën 1(b) të Shtojcës III të Rregullores së Këshillit (KE) nr. 448/98; [1]

[2] *(1) GJ Z L 58, 27.2.1998, f. 1.*
(2) GJ Z L 310, 30.11.1996, f. 1.
(3) GJ Z L 58, 28.2.2002, f. 1.
(4) GJ Z L 59, 6.3.1991, f. 19.
(5) GJ Z L 51, 1.3.1996, f. 48.

(c) shpërndarjen e FISIM-it midis industrive përdoruese, bazuar në stokun e huave dhe depozitave për çdo industri ose, nëse ky informacion nuk është i besueshëm, mbi produktin (output-in) për çdo industri;

(d) llogaritjen e FISIM-it me çmime konstante, në bazë të formulës së parashikuar në pikën 3 të Shtojcës III të Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 448/98.

2. Shtetet Anëtare i transmetojnë Komisionit rezultatet e llogaritjeve të bëra në zbatim të këtij Neni si pjesë e tabelave të referuara në Nenin 3 të Rregullores (KE) Nr. 2223/96 (Programi i transmetimit të të dhënave të llogarive kombëtare), duke përfshirë llogaritjet retroaktive që nga viti 1995 e në vazhdim.

Neni 2

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e 20-të pas botimit të saj në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Ajo zbatohet nga 1 janari 2005.

Kjo Rregullore është e detyrueshme në tërësinë e saj dhe zbatohet drejtpërdrejt në të gjitha Shtetet Anëtare.

E bërë në Bruksel, 23 tetor 2002.

Për Komisionin
Pedro SOLBES MIRA
Anëtar i Komisionit